

Shtojca nr.3: Manual i përgatitjes së Studimit të Rastit

Manual i përgatitjes së Studimit të Rastit (Studimet rast-raport)

Studimi i rastit është një studim i cili realizohet nga studentët tek pacientët e shtruar në ambjentet e ndryshme spitalore. Ka si qëllim studimin, analizimin apo dhe vlerësimin që nga momenti i pranimit të pacientit në spital, periudhën e konvaleshencës deri në momentin kur ai del nga spitali, ku më parë ai duhet të përgatitet nga ana fizike dhe psikike.

Studimet e rastit paraqiten në format A4 (Portrait).

Paragrafët duhet të ndahen pas një fjalie ose dy fjaltive të gjata. Numri i faqeve duhet të shënohet nga faqja ku është shkruar hyrja e punimit.

Për të paraqitur një studim rasti duhet të përdoret llojio shkrimit “TIMES NEË ROMAN” 12. Titujt apo dhe nëntitujt shënohen me BOLD dhe me shkrim pak më të madh.

Në fillim të materialit pas faqes së parë të kopertinës duhet të jetë e vendosur “Lista e përmbajtjes”

Shëmbull.

1. HYRJA	1
1.1 Anatomia dhe fiziologjia e mushkrive	1
1.2 Bronkopneumonia, faktorët etiologjikë dhe simptomatologjia	2
1.3 Diagnostikimi mjekësor	3
1.4 Mjekimi	4
2. PËRMBAJTJA	5
2.1 Vlerësimi fillestar	5
2.2 Diagnozatat infermierore	6
2.3 Planifikimi infermieror	7
2.4 Zbatimi dhe kujdesjet infermierore	8
3. PËRFUNDIMI	9
3.1 Vlerësimi përfundimtar infermieror	9
4. REFERENCAT	10

Shpesh herë në studimet e rastit mund të përdoren foto të ndryshme të cilat shërbejnë si shëmbuj të ndryshëm të elementeve përbërës të studimit. Madhësia e këtyre fotove nuk duhet të jetë më e madhe se 3cm. Nuk është e nevojshme që në studim të jenë më shumë se 3 foto.

Një studim rasti duhet të ketë 5 faza:

1. Titulli i punimit

- Hyrja:** Fillimi i studimit të rastit duhet të fillojë me anatomicën e organit që është prekur nga patologjia, më pastaj fiziologjia. Më pas flitet për patologjinë, etiologjinë, klinikën karakteristike, diagnozat diferenciale. Kjo pjesë e studimit duhet të përbëjë 10% të tërë punimit. (p.sh nëse i gjithë punimi është 20 fletë, dy fletë duhet ti përkasë kësaj pike të studimit)
- Përmbajtja: Kjo pjesë e studimit ka të bëjë me paraqitjen e rastit duke përshkruar 4 etapat e para të procesit infermieror:

- Mbledhja e të dhënave,
 - Diagnozat Infermierore: Diagnozat infermierore duhet të jenë bindëse duke u bazuar në gjendjen shëndetësore të pacientit
 - Planifikimi I ndërhyrjeve
 - Zbatimi
3. Përfundimi: kjo është faza përfundimtare e procesit infermieror Vlerësimi I ndërhyrjeve infermierore.
 4. Referencat: Referencat vendosen të radhitura në bazë të mënyrës së paraqitjes në pjesën teorike të studimit.
 - Mund të jenë numerike - p.sh [1]ose Harvardiane (p.sh Burazeri 2010)
 - Si referencë meren gjithmonë librat dhe artikujt të botuara në 5 vjecarin e fundit.
 - Referencat duhet të jenë të bazuara në burime shkencore.
 - Në këtë rast në referenca shënohet në këtë mënyrë.

Libër: Emrii Autorit, Titulli librit, vitii botimit, ISBN, nr i faqes ku është marë citimii juaj. Psh

Burazeri G et al . “Shëndet Publik” 2010 ISBN 978 – 99956 – 48 – 46 – 6, fq 72 – 75.

Artikull Shkencor: Emrii autorit, titulli artikullit, titulli revistës, vitii botimit, ISBN apo ISSN, numrii faqes ku është artikulli. Psh

Hasani V. et al : The Prevalence of β Thalassemia in the Department of Pediatric, Regional Hospital of Vlore. 2007 -2011 Journal of Chemical, Biological and Physical Sciences An International Peer Review E-3 Journal of Sciences Available online at www.jcbosc.org February 2013- April 2013, Vol. 3, No. 2, - ISSN: 2249 –1929 pg. 1169-1173.

Kartela infermierore: Çdo studim rasti duhet detyrimisht të shoqërohet me kartelën infermierore përkatëse të plotësuar tek pacientii marë në studim. Çdo fletë e kartelës duhet të plotësohet saktë, në mënyrë kronologjike dhe shumë qartë.